

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE TREGËTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**" GIA 2019" SH.P.K**

Në Tirane më datë 18/12/2018 si me poshte ,

Z. **Lorenc Ndreu**, atesia Ali lindur me **27.01.1967**, banues ne Tirane, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga Karta e Identitetit me nr. **G70127046U** dhe e numer leternjoftimi 026764259 dhe Z.Arjan Mefaja atesia Islam lindur me **02.09.1974** banues ne Tirane , me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga Karta e Identitetit me nr. H40902010J e numer leter njoftimi 031768770. **me cilësinë e ortakeve të shoqerise dhe me vullnetin tone të lirë e të plotë vendosem të krijojme shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin**

**" GIA 2019 " SH.P.K**

me adrese : blloku magazinave te tregtise ne rrugen Zenel Bastari hyrja n 1, n pasurie 5/197-N8, kati 3, zona kadastrale 8340.

.....

**Neni 1**

**EMËRTIMI DHE QENDRA E SHOQËRISË**

**EMËRTIMI: " GIA 2019 " SH.P.K**

**SELIA:** blloku magazinave te tregtise ne rrugen Zenel Bastari hyrja n 1, n pasurie 5/197-N8,kati 3, zona kadastrale 8340.

.....

Shoqëria do të jetë person juridik me regjistrimin në QKB sipas nenit 22 të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" e në bazë të Ligjit Nr.9901 të datës 14.04.2008 "PËR TREGËTARËT DHE SHOQËRITË TREGËTARE". Shoqëria do të gëzojë të gjithë të drejtat si person juridik dhe do të fillojë veprimtarinë e saj nga data e regjistrimit në **Q.K.B.-**

**Neni 2**

**QËLLIMI I SHOQËRISË**

*Objekti i veprimtarisë se Shoqërisë do të jetë:*

**1.Prodhimin e pjeseve te siperme te kepuceve, kepuceve dhe artikujve te veshjeve te cfarëdolloji, per llogari te vete dhe/ose per llogari te te treteve, prodhim fazon me destinacion kryesor vendet e huaja dhe/ose tregun e brendshem.**

Aktivitetet që do të kryhen në përputhje me dispozitat legjislative në fuqi. Blerjen e lëndës së parë dhe aksesoreve që kanë të bëjnë me prodhimin e pjesëve të kepuceve të çfaredolloji, të kepuceve të perfunduara dhe aksesoreve për manufakturen e artikujve të veshjes të çfaredolloji. Shitjen Brenda vendit ashtu dhe jashtë vendit të kepuceve, artikujve të veshjes të çfaredolloji.

### Neni 3 REGJISTRIMI JURIDIK I SHOQËRISË

"Shoqëria", në veprimtarinë e saj bazohet në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë. Kjo shoqëri tregëtare krijohet me objektivin për të vazhduar veprimtarinë për një periudhë kohore pa afat.-

Me vendim të "Ortakeve", mund të ndryshojë regjimin juridik të Shoqërisë, në qoftë se në të ardhmen krijohen përmasa më të favorshme për funksionimin e saj sipas Legjislacionit Shqipëtar. Në këtë rast "Ortaku" do të përshtasë "Kontratën e Themelimit", dhe "Statutin e Shoqërisë", si dhe regjistrimin e tyre nga organet kompetente Shqipëtare.

"Shoqëria" gëzon personalitet juridik nga dita e miratimit dhe e regjistrimit të tregëtar në Q.K.B.-

"Shoqëria" mund të ketë pasuri të luajtëshme dhe të paluajtëshme në përputhje me dispozitat e Legjislacionit Shqipëtar.

Pasuria mbrohet sipas dispozitave të ligjit në fuqi.

"Shoqëria" do të ketë vulën e saj të cilën do ta caktojë me Vendimin e Ortakeve të shoqërisë.-

### Neni 4 KAPITALI-THEMELTAR

Për të siguruar funksionimin fillestar të Shoqërisë, "Ortaket e shqërisë" formojnë kapitalin fillestar të shoqërisë prej 100 000 Lekë, , kapitali është i ndarë në 2 kuota të ndara 51% të kapitalit Z.Lorenc Ndreu dhe 49% të kapitalit Z.Arjan Mefaja.

Nga momenti i vendosjes së kontributit të kapitalit themeltar të Shoqërisë, Shoqëria fiton të drejtën e pasjes, përdorimit dhe disponimit të këtij elementi pasuror, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë dhe urdherimet e këtij Akt Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë. Shtesa e kapitalit themeltar, vendoset me vullnetin e ortakeve. Kapitali themeltar mund të shtohet në varësi të aktivitetit, nga kontributet plotësuese të ORTAKËVE sipas përqindjes së tyre në këtë kapital, me përjashtim të rasteve kur vendoset unanimitet kundërta.-

Shtesa e kapitalit themeltar, vendoset me vendim të Ortakeve të shoqërisë.---

Kapitali I shoqërisë kontribuar nga çdo ortak do të regjistrohet në librin e regjistrimit të kapitalit të shoqërisë.

## Neni 5

### DREJTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria drejtohet nga këto organe:

Nga Administratori I Përgjithshëm I shoqërisë.

Mënyra e emërimit dhe kompetencat e tij përcaktohen nga statuti i shoqërisë në përputhje me Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Në kuptim të këtij Akti-themelues , **Ortakët e shoqërisë janë**

**Z. Lorenc Ndreu dhe Z.Arjan Mefaja**

Detyrën e administratorit do ta kryejë, **Z.Lorenc Ndreu** për një afat kohor **5-vjeçar**, nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB.-

## Neni 6

### ADMINISTRATORI

Ortakët e shoqërisë vendosen që administratori I Shoqërisë : "**GIA 2019**" sh.p.k të jetë **Z.Lorenc Ndreu** .Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet ligjore që janë në interes të shoqërisë në përputhje me Statutin e Aktin e Themelimit të saj.

Administratori do të ketë autoritet të përgjithshëm në aktivitetin zakonshëm dhe jashtzakonshëm të shoqërisë dhe ka të drejtën e marrjes së çdo ndermarrje dhe çdo veprimi që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e qëllimit të shoqërisë me përjashtim të rasteve që ligji "Mbi Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" i kufizon. Administratori ka të drejtë t'i propozojë mbledhjes së Asamblesë së Oetakëve planin e mbledhjeve duke marrë vendime për zhvillimin e veprimtarive të shoqërisë, duke përcaktuar dhe linjat kryesore të veprimtarisë së shoqërisë.

Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përmbushjen e aktivitetit të saj në përputhje me parashikimet në statutin e kësaj shoqërie.

Organi Administrativ (administratori) është kompetent për të:

realizuar mbledhjen e Asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim 15 ditë më parë:

- miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tre mujore;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- të marrë në punë personat e ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;

- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e foondeve të ndryshme (të veçanta), ndarjen e fitimit etj.:
- përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në çeshtje gjyqësore që mund të ketë shoqëria:
- emëruar përfaqësues duke I deleguar të gjitha ose ose një pjesë të kopetencave të tij.

#### Neni 7

### SIGURIMI I SHOQËRISË

Pasuria e Shoqërisë sigurohet në bazë të Legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.-

#### Neni 8

### BILANCI, VEPRIMTARIA EKONOMIKE, DETYRIMET

Shoqëria mban përgjegjësi për të gjitha detyrimet shtetërore, sigurimet shoqërore, etj. Ortaket themelues ose persona të tjerë të autorizuar prej tij kanë të drejtë

që me nxjerrjen e bilanceve ekonomike, çdo fund-viti kalendarik, të përfitojnë përqindjet e realizuara nga veprimtaria private.

Shoqëria "**GIA 2019**" **SH.P.K** ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.-

Të gjitha mosmarrveshjet me person afizik ose juridik, vendas ose të huaj si dhe organet shtetërore, zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### Neni 9

### KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Afati I veprimtarisë të kësaj Shoqërie është *pa afat të caktuar*, por aktiviteti fillon nga data e nënshkrimit të këtij akti. Afati I funksionimit të Shoqërisë është afati I veprimtimit të Akt-Themelimit, që fillon nga data e regjistrimit në QKB.-

#### Neni 10

### LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Raste dhe proceduara e likujdimimit të Shoqërisë, si dhe mbarimi i Afatit të Aktit të Themelimit të shoqërisë përcaktohen në **Statutin** e saj.

**Neni 11**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME**

*Ndryshim etë favorshme ne Legjislacionin Shqipëtar*

Ky Akt-Themelimi I Shoqërisë ka si aneks Statutin e Shoqërisë. Çdo ndryshim dhe shtesë e këtij Akt-Themelimi, si dhe Statutit, bëhet me Vendim të Ortakeve të shoqërisë. Në qoftë se në Republikën e Shqipërisë shpallen ligje, dekrete, ose vendoset një politik më e favorshme nga Legjislacioni ekzistues gjatë kohës së vendosjes së shoqërisë, atehere "Ortaket", kanë të drejtë të drejtohet organeve përkatëse shtetërore që të zbatojnë legjislacionin më të favorshëm.

Çështjet e pa mbuluara nga ky statut do të rregullohen nga legjislacioni Shqiptar dhe në veçanti nga **Ligji Nr.9901 dt. 14.04.2008 "Mbi Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare"**.

Ky Akt-Themelimi nënshkruhet në Tiranë, dhe hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe.-

**ORTAKET E SHOQERISE**

**LORENC NDREU**



**ARJAN MERAJA**

